

E DREJTA PËR INFORMIM

Bashkëpunim me KiE për projektin “Mbrojtja e të drejtës së shprehjes dhe të medias”

Në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës (KiE), znj. Alina Tatarenko, Shefe e Divizionit për Bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes, z. Paul Meyer, menaxher projekti dhe znj. Erkanda Bujari, nga Zyra e KiE në Shqipëri.



Palët diskutuan për bashkëpunimin në kuadër të zbatimit të projektit rajonal “Mbrojtja e të drejtës së shprehjes dhe të medias në Ballkanin Perëndimor”. Kjo iniciativë e KiE u prezantua gjatë këtij takimi dhe ka në fokus lirinë e shprehjes, aksesin në informacionin publik, mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e gazetarëve, si dhe fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve dhe ndërveprimin me organizata të shoqërisë civile. Përfaqësuesit e KiE vlerësuan përfshirjen e Zyrës së Komisionerit në këtë projekt për ndarjen e eksperiencës dhe praktikave të mira në lidhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, si dhe për njohjen e Konventës së modernizuar të KiE “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108+) dhe asaj “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa e Tromsos). Zyra e Komisionerit theksoi si të rëndësishme për këtë projekt organizimin e aktiviteteve/fushatave ndërgjegjësuese, rritjen e kapaciteteve të stafit të saj, të institucioneve të administratës publike, por edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile, mbi promovimin e transparencën dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.


Shkëmbim eksperience për forcimin e kapaciteteve në fushën e të drejtës për informim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte pjesëmarrëse në seminarin për trajnimin e rasteve të veçanta në fushën e të drejtës për informim (Case Handling Workshop – CHW).



I organizuar nga Zyra e Këshillit për Transparencë të Spanjës, ky aktivitet 2-ditor, mbledhi së bashku 30 përfaqësues nga autoritete homologe evropiane. Në këtë seminar u shkëmbye eksperiencë dhe praktika të mira për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit, për ushtrimin e tyre nga qytetarët dhe rritjen e transparencës nga institucionet/strukturat publike. Gjatë aktivitetit u diskutua, ndër të tjera, mbi çështje që kanë të bëjnë me balancën në trajtimin e të drejtës për informim në raport me atë për mbrojtjen e të dhënave personale; në lidhje me forcimin e transparencës proaktive dhe metodologjitë në monitorimin efektiv të saj; trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me punësimet në administratën publike; problematika mbi përdorimin e teknologjisë në këtë fushë; apo ushtrimin e kësaj të drejte nga gazetarët. Zyra e Komisionerit, në këtë seminar, mbajti një prezantim në lidhje me raste ku transparenca e autoriteteve publike ndërthuret me trajtimin e informacionit/dokumentacionit të rezervuar apo konfidencial.

KONSULTONI FAQEN WWW.IDP.AL PËR TU NJOHUR ME TË REJAT MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Takimi i 4-të i Komitetit Ekzekutiv të ICIC

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në mbledhjen e 4-të të Komitetit Ekzekutiv të *International Conference of Information Commissioners-ICIC*, e cila u mbledh vetëm disa ditë përpara zhvillimit të Konferencës në Shqipëri. Zhvillimi i edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimi iu besua për herë të parë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Tema qendrore e këtij edicioni është *“Fuqizimi i individëve nëpërmjet aksesit në informacion, sigurimi i transparencës dhe gjithëpërfshirjes në një botë të ndërlidhur”*.



Në këtë takim, Zyra e Komisionerit raportoi mbi progresin e bërë në kuadër të përgatitjeve të organizimit të Konferencës, ku paraqiti një informacion mbi numrin e pjesëmarrësve dhe vendeve anëtare që do të marrin pjesë, si edhe bëri një panoramë të aspekteve logjistike të Konferencës.

Gjithashtu, Komiteti diskutoi mbi draftin e Deklaratës Publike, dokument i cili miratohet nga anëtarësia në sesionin e mbyllur. U propozuan disa ndryshime të tekstit të cilat u reflektuan nga Sekretariati i International Conference of Information Commissioners-ICIC.

Komiteti vijoi me procese të tjera të punës si aderimi i Autoritetit Holandez për aksesin në dokumente zyrtare, si anëtarë i ri i ICIC. Gjithashtu, u paraqit edhe një informacion përmblendhës mbi zgjedhjet për Presidencë/Sekretariat dhe dy anëtarëve të rinj të ICIC.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania